

---

**MISIONI NDËRKOMBËTAR PËR VËZHIM TË ZGJEDHJEVE**  
**Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë**  
**Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 11 dhjetor 2016**

---

**DEKLARATA E REZULTATEVE DHE KONKLUZIONEVE PARAPRAKE**

---

**KONKLUZIONET PARAPRAKE**

---

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit ishin një hap thelbësor në zgjidhjen e krizës së thellë politike dy vjeçare. Forcat kryesore politike ranë dakord për një seri të ndryshimeve ligjore dhe institucionale për të siguruar një fushë loje për këto zgjedhje. Çështjet themelore, të tilla si regjistrimi i votuesve dhe mediat, janë ende për t'u trajtuar në mënyrë të qëndrueshme. Fushata ishte konkurruese, por u zhvilluan në një mjedis të karakterizuar nga mosbesimi publik në institucionet dhe në sistemin politik si dhe akuzat për shtrëngimin e votuesve. Administrata zgjedhore sfidoi me përgatitjet për zgjedhjet dhe tejkaloi një numër të afateve, por dita e zgjedhjeve në përgjithësi u administruar mirë dhe vazhdoi pa incidente të mëdha.

Korniza ligjore në përgjithësi është e favorshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Përmirësimet e rëndësishme në legjislacionin zgjedhor në vitin 2015 trajtuan shumicën e rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-së dhe të Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës. Ndryshimet tjera në vitin 2016 parashtruan mekanizma të përkohshme ndërpartiake për mbikëqyrjen politike të aspekteve kyçe të procesit zgjedhor. Megjithatë, disa rekomandime mbeten të patrajuara dhe disa dispozita të caktuara janë të paqarta ose në kundërshtim me ligje të tjera. Përveç kësaj, përderisa procesi i reformës gëzonte mbështetje nga katër partitë më të mëdha politike, u morrën vendime nën presion të kohës dhe pa konsultime me aktorët e përshtatshëm zgjedhorë.

Përgatitjet e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) për zgjedhjet ishin të penguar nga organizimi joefikas i brendshëm, vendimmarrje të politizuar dhe afateve ligjore të shkurtuara. Disa afate ishin të tejkaluara dhe disa procedura nuk ishin të sqaruara. Aktivitetet e KSHZ-së nuk ishin gjithmonë transparente, pasi që ai shpesh mbante seanca të mbyllura dhe jo gjithmonë publikonte vendimet e tij. Komisionet e nivelit më të ulët në përgjithësi punuan në mënyrë profesionale, edhe pse disa prej tyre kishin mungesë të hapësirës adekuate, financim në kohë dhe të pajisjeve.

Në total, ishin të regjistruar 1,784,416 votues. Për të trajtuar mosbesimin afatgjatë në saktësinë e Listës së votuesve, për herë të parë KSHZ-ja shqyrtoi regjistrin e votuesve me kontrollim të kryqëzuar të disa bazave të të dhënave dhe me kryerjen e kontrollimeve në terren. Rishikimi nuk garanton përmirësim të qëndrueshëm pasi që ai aplikohet vetëm në këto zgjedhje. Mungesat ligjore dhe strukturore për mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve duhet trajtuar më tutje. Prosesi i shqyrtimit përmirësoi saktësinë e regjistrit të votuesve, mirëpo duket se kjo mund të ketë sjellur deri te humbja e të drejtës së votës të disa qytetarëve për këto zgjedhje.

KSHZ-ja regjistroi gjashtë parti politike dhe pesë koalicione për këto zgjedhje. Regjistrimi ishte në përgjithësi përfshirës, por ishte i ndikuar negativisht nga mungesa e qartësisë ligjore për procedurat dhe nga refuzimi i listave të kandidatëve të dy partive për shkak të mospajtueshmërisë. Në përputhje me kuotën e zgjeruar për pjesëmarrjen e grave, 41 për qind të kandidatëve ishin gra, edhe pse vetëm ishin në krye të vetëm 4 listave nga 58.

Fushata Edhe pse të drejtat themelore ishin të respektuara në përgjithësi dhe garuesit ishin në mundësi që të mbajnë fushatë të lirë, zgjedhjet u zhvilluan në rrethana të karakterizuara nga mungesa e besimit publik në institucionet dhe sistemin politik. Akuzat për frikësimin e votuesve, shtypja e gjërë mbi të punësuarëve të shërbimit publik, blerja e votave, kërcnimet si dhe keqpërdorimi i resurseve administrative vazhduan gjatë zgjedhjeve. MVZ i OSBE/ODIHR-së verifikoi një duzinë të këtyre

fajësimeve. Veprimet e tilla janë në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.

Rregulloret për financimin e fushatave janë gjithëpërfshirëse dhe kërkojnë raportime të shpeshta nga kandidatët. Megjithatë, transparenca u minimizua nga mungesa e kërkesës për të mbështetur raportet me pasqyrat dhe faturat bankare. Raportet e paraqitura nga kandidatët më 1 dhe 10 dhjetor zbuluan mbishpenzime të rëndësishme, veçanërisht nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)

Mjedisi i shumëllojshëm i mediave është i ndarë përgjatë vijave politike dhe etnike. Kandidatët kishin mundësi të që të kanë fushatë në media publike dhe private mes reklamimit të paguar dhe falas. Monitorimi i mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR tregoi se mediat publike gjerësisht mundësuan kohë të përshtatshme për garuesit, disa prej mediave private demonstuan anësim në favor të partisë në pushtet. Një numër i bashkëbiseduesëve, duke përfshirë edhe gazetarë, shprehën shqetësim në lidhje me vetë-censurimin dhe pavarësinë editoriale për shkak të interesave politike dhe ato të biznesit që favorizonin partitë në pushtet. Edhe pse ndryshimet e fundit ndaluan reklamim të financuar nga qeveria dhe mbulim të zyrtarëve shtetërorë gjatë fushatës, reformat e rëndësishme në media të parashikuara në Marrëveshjen e Przhinos, mbeten për t'u zbatuar.

Temat në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike u mbizotëruan në fushatë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet institucionale mes komuniteteve etnike maqedonase dhe ato shqiptare. Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë kërkoi në mënyrë aktive vota nga komuniteti etnik shqiptar, duke shpallur eshë kandidatë të etnicitetit shqipëtar. Mbulimi i kandidatëve romë nga ana e mediat shpeshherë përdorte stereotype.

Trajtimi i rekomandimeve të mëparshme dhe ndryshimet ligjore, si dhe miratimi i rregullores së KSHZ-së për procedurad, i përforcoi garancat ligjore për zgjedhje të kontesteve. Mirëpo, shumica e ankesave në administratën zgjedhore dhe gjykatat ishin të refuzuara në baza procedurale apo juridike. Gjykata administrative i mbajti seancat e saja pas dyerëve të mbyllura. Një numër i bashkëbiseduesëve ngritën shqetësime në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Përkundër përmirësimeve të dukshme të ligjit, zbatimi i procedurave për zgjedhjen e kontesteve zgjedhore nuk ka siguruar plotësisht mundësinë për dëmshpërblim ligjor efektiv, që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardeve të Këshillit të Evropës.

Dita e zgjedhjeve u zhvillua në mënyrë të rregullt dhe pa incidente të mëdha, edhe pse u vërenë disa parregullsi procedurale, sidomos gjatë numërimit. Votuesit morrën pjesë në numër të madh dhe votimi u vlerësua përgjithësisht pozitivisht nga vëzhguesit. Vëzhguesit kanë vërejtur një numër të personave që nuk j'u lejohua të votojnë pasi që ishin të fshirë nga Lista e votuesve gjatë shqyrtimit të fundit të regjistrimit të votuesve. Transparenca e procesit zgjedhor përfitoi nga prania aktive e vëzhguesve të shumtë qytetarë dhe të partive. Pozitivisht, KSHZ-ja publikoi rezultatet preliminare sipas vendotimeve në internet gjatë tërë natës, me pjesëmarrjen paraprake të votuesve prej 67 për qind.

---

## REZULTATET PARAPRAKE

---

### Historiku

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit gjerësisht shikohen si një provë vendimtare për funksionimin demokratik të institucioneve, pas krizës politike dyvjeçare.<sup>1</sup> Këto zgjedhje janë zgjedhjet

---

<sup>1</sup> Më 9 nëntor, Raporti I politikës për zgjerim i Komisionit Evropian vëreu se "vendi përballeshte me vazhdimësi të krizës më të rëndë politike që nga viti 2001. Demokracia dhe sundimi i ligjit janë të sfiduara vazhdimisht, posçarishit për shkak të zënies të shtetit që ndikon në funksionimin e institucioneve demokratike dhe fushat kyçe të shoqërisë. Vendi vuan nga një kulturë përçarëse politike dhe mungesa e kapacitetit për kompromis".

e katërta të parakohshme parlamentare të rradhës që nga viti 2008. Zgjedhjet e fundit u mbajtën në vitin 2014 dhe kjo rezultoi me një qeveri të formuar nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), me 61 vende, dhe të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), me 19 vende. Opozita përfshinte Lidhjen Social Demokratike të Maqedonisë (LDSM) me 34 vende dhe Partinë Demokratike të Shqiptarëve (PDSH) me 7 vende. Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) dhe Opsioni Qytetar për Maqedoninë (GROM) kishin nga një vend secili.

Partia kryesore opozitare bojkotoi parlamentin, duke deklaruar se zgjedhjet e vitit 2014 ishin të manipuluar.<sup>2</sup> Kriza u thellua në shkurt të vitit 2015, kur përgjimet e paligjshme inkriminuese, gjoja implikonin qeverinë dhe zyrtarët publikë për korrupsion, mashtrim zgjedhor dhe abuzim të pushtetit, rezultuan me protesta të shumta. Më 15 korrik, si pjesë e marrëveshjes në Przhino, e ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët, u bë thirrje për zgjedhje të parakohshme parlamentare për 24 prill 2016 dhe u krijua Zyreja e Prokurorit Special për të hetuar akuzimet nga përgjimet.<sup>3</sup>

Zgjedhjet u zhvendosën për 5 qershor me arsyetimin se kushtet kryesore nuk ishin të arritura, përkatësisht, pastrimi i Listës së votuesve, reformat në media, si dhe masat mbrojtëse për shkëputjen e aktiviteteve partiake nga ato shtetërore. Klima politike u përkeqësua pas 12 prillit kur Presidenti Gjorgje Ivanov lëshoi falje të hapur për të gjithë personat që ishin të akuzuar, nën hetim apo të dyshuar për përfshirje në skandalin e përgjimeve. Gjithë partitë më të mëdha politike e ndëshkuan faljen dhe i bënë thirrje presidentit që të shfuqzojë vendimin e tij. Falja nxiti proteste dhe kundërproteste. Demonstruesit, të bashkuar nën umbrellën *Protestoj*, bënë thirrje për dorëheqje nga presidenti dhe për anulim të zgjedhjeve. Opozita i bojkotoi zgjedhjet dhe nga katër nënshkruesit e Marrëveshjes së Przinose vetëm VMRO-DPMNE dorëzoi listat e kandidatëve. Më 25 maj, Gjykata Kushtetuese e shpalli shpërbërjen e parlamentit si jokushtetues dhe u anuluan zgjedhjet e 5 qershorit.

Përpjekja e tretë për organizimin e zgjedhjeve këtë vit u pasua me nënshkrimin e një marrëveshjeje të re në korrik nga ana e katër partive kryesore politike, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.<sup>4</sup> U prezantuan mekanizmat e përkohshme për mbikëqyrjen ndërpartiake të disa aspekteve të procesit zgjedhor, duke përfshirë regjistrimin e votuesve dhe mbikëqyrjen e mediave. Më 17 tetor, parlamenti u shpërbë për herë të dytë këtë vit dhe zgjedhjet u caktuan për 11 dhjetor.

## Sistemi zgjedhor dhe Korniza ligjore

Në vend zgjedhen gjithësej 120 anëtarë të parlamentit (deputetë) për një mandat katër-vjeçar, në bazë të një sistemi proporcional duke përdorur lista të mbyllura, nga 20 në secilën prej gjashtë njësjive zgjedhore. Si rezultat i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në vitin 2015, deri në tre deputetë shtesë do të zgjedhen në një zonë të vetme jashtë vendit.<sup>5</sup> Numri i deputetëve të zgjedhur në njësinë jashtë vendit, nuk është domosdoshëm që të jetë i ndërlidhur me daljen e votuesve.

<sup>2</sup> Deklarata e MNVZ nga viti 2014 për Gjetjet dhe Konkluzionet Paraprake arriti në përfundimin se "zgjedhjet presidenciale të 27 prillit 2014 dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare u administruan në mënyrë efikase, duke përfshirë edhe ditën e zgjedhjeve. Kandidatët ishin në gjendje që të bëjnë fushatë pa pengesa dhe se u respektuan liritë e tubimit dhe të organizimit. Megjithatë, fushata e partisë në pushtet nuk i kishte ndarë në mënyrë adekuate aktivitetet e saja partiake dhe shtetërore, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 dhe standardet e Këshillit të Evropës "

<sup>3</sup> Katër partite kryesore parlamentare e nënshkruan [Marrëveshjen e Përzihosë](#) dhe [Protokolin](#), me ftesë për implementimin e masave përkatëse për zgjedhjen e krizës politike, duke përfshirë edhe redormat zgjedhore dhe në media.

<sup>4</sup> [Marrëveshja e 20 korrikut](#)

<sup>5</sup> Kandidati zgjedhet nëse lista ka fituar një numër minimal të votave të barabartë me deputetin e zgjedhur në vend me numrin më të vogël të votave gjatë zgjedhjeve të mëparshme; për zgjedhjet e ardhshme numri është 6,478 vota. Mund të zgjedhen deri më tre kandidatë; kandidati i dytë dhe i treti do të janë të zgjedhur në qoftë se lista e tyre merr-fiton dy herë dhe tri herë më shumë vota, respektivisht.

Kodi Zgjedhor lejon devijime deri në pesë për qind nga numri mesatar i votuesve të regjistruar në njësitë zgjedhore në vend.<sup>6</sup> Më 25 tetor, partia Uniteti kundërshtoi mbajtjen e zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese me arsyetim se njësia zgjedhore 6 devijon me 5.65 për qind. Gjykata nuk ka vendosur mbi këtë çështje para ditës së zgjedhjeve.

Korniza ligjore është përgjithësisht e favorshme për zhvillim të zgjedhjeve demokratike.<sup>7</sup> Si një hap pozitiv, legjislacioni zgjedhor është rishikuar në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2015 si pjesë e Marrëveshjes së Przhino-së. Ndryshimet trajtuan shumë rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-së dhe të Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me parimin e votimit të barabartë për votim jashtë vendit, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), si dhe masat për mbulim mediatik të balancuar gjatë fushatës. Ato gjithashtu i përforcuan dispozitat për ndarjen e partisë dhe të shtetit, si dhe për raportimin e financave të fushatës. Përveç kësaj, votuesit tani mund të paraqesin ankesa në çdo fazë të procesit zgjedhor dhe gjykatat duhet të vendosin për kontestet zgjedhore brenda afateve më të shkurta.<sup>8</sup> Pas marrëveshjes së korrikut, me amendamentet plotësuese mundësuan formimin e Komisionit të Përkohshëm për mbikëqyrjen e mediave dhe u kërkua që qytetarët me të dhëna "të dyshimta" të reregjistrohen në Listën e votuesve në mënyrë aktive për këto zgjedhje. Dispozitat e fundit janë të aplikueshme vetëm për zgjedhjet e tanishme, duke sinjalizuar nevojë për reforma të vazhdueshme për trajtimin e këtyre çështjeve në mënyrë të qëndrueshme.

Ndryshimet e vitit 2015 e përmirësuan Kodin Zgjedhor, por disa çështje të vjetra mbeten të patrajtuara, duke përfshirë çështjet rreth regjistrimit të kandidatëve, tërheqjen e kandidatëve dhe listave, si dhe shqyrtimin publik dhe periodik të kufinjëve të njësisve nga organe të pavarura. Disa artikuj janë të paqartë ose në kundërshtim me ligjet dhe rregullat tjera, duke e bërë të pasigurt zbatimin e tyre. Përveç kësaj, ndryshimet ligjore u miratuan në shpejtësi nga parlamenti, pas procesit të reformës të cilit i mungonte transparenca dhe konsultim kuptimplotë me palët e ndikuara jashtë katër partive kryesore, duke i përfshirë edhe institucionet relevante shtetërore, partitë tjera politike dhe shoqërinë civile. Kjo është në kundërshtim me përcaktimet e OSBE-së.<sup>9</sup>

## Administrata Zgjedhore

Zgjedhjet administrohen nga KSHZ-ja, 80 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ-të) dhe 3,480 Këshille zgjedhorë (KZ-të). U themeluan edhe 46 KZ në zyrat diplomatiko-konsulare për votim jashtë vendit.

KSHZ-ja përbëhet nga nëntë anëtarë: tre të emëruar nga partitë në qeveri, tre nga opozita dhe tre ekspertë të pavarur të zgjedhur përmes rekrutimit të hapur. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjedhen nga radhët e anëtarëve të pavarur. KKZ-të përbëhen nga pesë nëpunës nga administrata të zgjedhur me rastësi dhe të emëruar për mandat pesë-vjeçar prej prillit të vitit 2016. KZ-të përbëhen prej tre nëpunës civilë të zgjedhur me rastësi, një anëtar i caktuar nga partitë qeveritare dhe një anëtar i caktuar nga partitë opozitare, të emëruar për mandate katër-vjeçare në nëntor të vitit 2016. Pavarësisht nga disa ndryshime të vonshme për përbërjen e KKZ-ve dhe KZ-ve, kërkesat për përfaqësim të balancuar etnik

<sup>6</sup> Seksioni 2.2 nga [Kodi i praktikave më të mira për çështjet zgjedhore nga Komisioni i Venedikut të Këshillit Evropian \(Praktikat më të mire\)](#) 2002 rekomandon që "largimi i lejueshëm nga norma nuk duhet të jetë më shumë se 10%, dhe sigurisht nuk duhet të tejkalojë 15%, përveç në rrethana të veçanta".

<sup>7</sup> Korniza ligjore përfshin Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, Ligjin për partitë politike, Ligjin për Financim të Partive Politike, dispozitat e Kodit Penal, Ligji për Media dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, si dhe rregulloret e shpallura nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ).

<sup>8</sup> Shih OSBE/ODIHR dhe [Opinionin e përbashkët](#) (të Komisionit të Venedikut) mbi Kodin Zgjedhor.

<sup>9</sup> Paragrafi 5.8 nga [OSBE Dokumenti i Kopenhagës nga viti 1990](#) parashikon se legjislacioni duhet të jetë "miratuar në fund të një procedure publike".

dhe gjinor në komisionet zgjedhore u respektuan gjerësisht. Megjithatë, vetëm dy nga nëntë anëtarët e KSHZ-së janë gra.<sup>10</sup>

Përgatitjet e KSHZ-së për këto zgjedhje ishin të penguar nga organizimi joefikas i brendshëm dhe sjellje vendimmarrje të politizuar. Disa afate të rëndësishme skaduan, por përgatitjet u kompletuan në ditën e zgjedhjeve.<sup>11</sup> Afati kohor i shkurtuar për zgjedhjet e parakohshme poashtu ndikoi negativisht aktivitetet e KSHZ-së. Vendimet e KSHZ-së miratoheshin në mënyrë unanime në përgjithësi. Megjithatë, për çështjet e kontestueshme politike anëtarët votonin në bazë të linjës partiake dhe shpeshherë zhvillonin diskutime të gjata procedurale që përfshinin edhe fjalor të "nxehtë" rreth interpretimeve të ligjit. Në disa raste, vendimet ishin qartë partiake. Për shembull, KSHZ-ja përcaktoi rendin e listave të kandidatëve në fletëvotimet me short, por i ndau listat në dy grupe duke ofruar vendet e para të fletëvotimit katër partive parlamentare të përfaqësuara në KSHZ-në.<sup>12</sup> Kjo i diskriminoi kandidatët tjerë, duke sfiduar përcaktimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës<sup>13</sup> Megjithatë, asnjë kandidat nuk u ankua për këtë çështje.

Masat për të siguruar transparencën e KSHZ-së nuk respektoheshin gjithmonë. Edhe pse të gjithë anëtarët, kandidatët dhe përfaqësuesit e autorizuar ishin të njoftuar në lidhje me seancat përkatëse të KSHZ-së, jo të gjitha vendimet u publikuan në faqen e internetit, siç kërkohet me ligj. Detyrimi për të publikuar procesverbalet e seancave të KSHZ-së brenda 48 orëve nuk respektoheshte rregullisht. Edhe pse seancat zyrtare ishin të hapura për vëzhguesit dhe mediat, KSHZ-ja shpesh herë zhvillonte seanca të mbyllura, edhe përskaaj dakordimit paraprak që çështjet thelbësore të vendosen në seanca publike. Kjo përfshinte vendime për procedurat e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve për aktivitete të ndryshme.<sup>14</sup> Këto praktika e minimizuan transparencën e punës së KSHZ-së.<sup>15</sup>

Komisionet e nivelit më të ulët në përgjithësi punuan në një mënyrë profesionale dhe transparente. MVZ i OSBE/ODIHR-së vërejti se disa KKZ kishin mungesë të ambientit dhe të pajisjeve adekuate në kohën e vizitave. Një numër i KKZ-ve informuan MVZ-në të OSBE/ODIHR-së se nuk kanë marrë fondet e nevojshme në kohën e duhur.

KSHZ-ja mbajti trajnime të shkallëzuara dhe krijoi program për mësim elektronik (e-learning), udhëzues dhe video për komisionet zgjedhore. Trajnimet e vëzhguara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së

<sup>10</sup> Komunitetet etnike që përbëjnë më shumë se 20 për qind të popullsisë në një komunë duhet të përfaqësohen në KKZ-të dhe KZ-të. Të paktën 30 për qind nga anëtarët në të gjitha organet zgjedhore duhet të jenë nga secila gjini.

<sup>11</sup> Afatet e kaluara përfshinin dorëzimin e Listave të votuesve partive politike, mbylljen e Listës së votuesve dhe publikimin e listave të kandidatëve. Kodi Zgjedhor parashikon që afatet për aktivitetet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të janë pesë ditë më të shkurtëra sesa ato të rregulltat, me përjashtim për kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore.

<sup>12</sup> Katër pozitat e para në fletëvotimet ishin, sipas renditjes, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, PDSH, BDI dhe koalicionit i udhëhequr nga LSDM-ja. Vendimi i KSHZ-së për mënyrën e hedhjes së shortit nuk është publikuar deri më sot.

<sup>13</sup> Paragrafi 7.6 nga [OSBE Dokumenti i Kopenhagës nga viti 1990](#) obligon shtetet pjesëmarrëse t'u mundësojnë "partiv e politike dhe organizatave garancat ligjore të nevojshme për mundësuat të garimit me njëri-tjetrin në bazë të trajtimit të barabartë para ligjit". Shih poashtu paragrafin 2.3 të [Kodit të praktikave më të mira të Komisionit të Venedikut nga viti 2002](#). Neni 6 i Ligjit kundër diskriminimit përcakton sjelljen diskriminuese si çdo "sjellje aktive dhe pasive nga autoritetet publike ... që krijon bazën për dhënien e privilegjeve ose vendosjen e personave/subjekteve në kushte të pafavorshme".

<sup>14</sup> Kjo përfshinte shtypjen e materialeve zgjedhore, IT softuer për rezultate, transportimin e anëtarëve të KZ-së në vendëvotimet jashtë vendit të votimit, dhe shërbime për edukim të votuesve. Dokumentacioni i tenderit nuk është bërë publik.

<sup>15</sup> Paragrafi 19 nga [Komenti 34 i Komitetit të përgjithshëm të KB-së për të drejtat e njeriut nga 2011](#) të nenit 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) thotë "Për të bërë efektive të drejtën e qasjes në informacion, partitë e Shtetit duhet të vënë në mënyrë proaktive informacionet e Qeverisë me interes publik, në domen publik. Partitë në Shtet duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar qasje të lehtë, të shpejtë, efektive dhe praktike në informacion të tillë". Shih poashtu paragrafin 3.1 të [Kodit të praktikave më të mira të Komisionit të Venedikut nga viti 2002](#)

ishin të plota dhe u vlerësuan pozitivisht nga pjesëmarrësit. Megjithatë, KSHZ-ja nuk sqaroi disa procedura që nuk ishin të shpjeguara në Kodin.<sup>16</sup> Mungesa e qartësisë kontribuoi për një zbatim jokonzistent të procedurave nga ana e komisioneve zgjedhore në ditën e zgjedhjeve.

KSHZ-ja zhvilloi një fushatë të kufizuar për edukimin e votuesve në televizion, mediat sociale dhe mediat e shtypura. Organizatat e shoqërisë civile poashtu zhvilluan fushata ndërgjegjëse për votuesit mbi fshehtësinë e votës dhe pjesëmarrjes së votuesve.

## Regjistrimi i votuesve

Regjistrimi i votuesve është pasiv, me përjashtim të votuesve që jetojnë përkohësisht jashtë vendit dhe të cilët duhet të regjistrohen në mënyrë aktive. Sipas Kushtetutës, qytetarët të moshës 18 vjeçare deri më ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë vote, përveç nëse janë të privuar nga e drejta e tyre ligjore me vendim të gjykatës. Megjithatë, vetëm votuesit me letërnjoftim të vlefshëm apo pasaportë biometrike dhe vendbanim të regjistruar janë të përfshirë në Listën e votuesve. Kodi Zgjedhor përmban dispozita kontradiktore lidhur me pranueshmërinë e votuesve jashtë vendit.<sup>17</sup> Për herë të parë në këto zgjedhje, fotografitë e votuesve ishin vendosur në listat e votuesve.

KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e Listës të votuesve. Pas Marrëveshjes nga Przhino, dhe si një mjet për të trajtuar mosbesimin afatgjatë në saktësinë e Listave të votuesve, KSHZ-ja ishte e detyruar të bëjë shqyrtimin e Listës të votuesve me kontrollime të kryqëzuara të bazave të të dhënave të 11 institucioneve shtetërore, e gjithë kjo ishte e mbështetur me kontrollimet në terren.<sup>18</sup> Procesi i shqyrtimit vëzhgoheshte nga katër partitë më të mëdha dhe kjo drejtoi në identifikimin e 39,502 të dhënave të votuesve si "të diskutueshëm". Nga këta qytetarë u kërkua që të reregjistrohen që të mos fshihen nga Lista, si një kërkesë e re ligjore.<sup>19</sup> Ndërsa procesi përmirësoi saktësinë e Listës së votuesve, duket se ka pasuar në humbjen e të drejtës së votes të disa qytetarëve.<sup>20</sup> Më 13 nëntor, KSHZ-ja vendosi që të fshin 28,341 të dhëna; votuesit e tillë nuk patën mundësinë të dëmshpërblimit ligjor që do t'ju lejonte që të shtohen në Listat e votimit dhe të kanë mundësinë për të votuar në ditën e zgjedhjeve. 171,500 votues tjerë u zhvendosën në një regjistër të veçantë të cilët konsiderohen se përkohësisht jetojnë jashtë vendit, por ata ende mund të votojnë në vend në adresën e tyre të regjistruar.

Përveç mundësisë për verifikim të regjistrimit të tyre gjatë tërë vitit, votuesit mund të shikojnë dhe të ndryshojnë të dhënat e tyre të regjistrimit në qendrat rajonale të KSHZ-së gjatë periudhës së shqyrtimit publik, nga 28 tetori deri më 11 nëntor. Përkundër kërkesave ligjore, zyrat rajonale të KSHZ-së nuk i shfaqën Listat e shtypura të votuesve dhe votuesit të cilët vizituan zyrat mundeshin vetëm të shikojnë të dhënat e tyre në kompjuterët e KSHZ-së. Votuesit kishin mundësi që të kontrollojnë të dhënat e tyre personale në internet, si dhe se kush është i regjistruar në adresat tjera. Sipas KSHZ-së, disa nga 10,274 votues të cilët vizituan zyrat e KSHZ-së kanë kërkuar korrigjime.<sup>21</sup>

<sup>16</sup> Për shembull, rinumërimi i fletëve të votimit nga KKZ-të dhe vulosja e materialeve të ndjeshme të zgjedhjeve nga KZ-të për dorëzimin në KKZ-të.

<sup>17</sup> Neni 41(4) thekson se vetëm votuesit me vendbanim në vend shtohen në Listën e votuesve. Neni 6(1) përcakton se çdo qytetar me "vendbanim në njësinë zgjedhore" ka të drejtën e votës, e cila do t'i përfshijë ato në njësitë jashtë shtetit.

<sup>18</sup> Kontrollimet në terren u zhvilluan nga 28 marsi deri më 6 prill. Më 26 prill, KSHZ-ja raportoi se janë regjistruar 44,308 votues të identifikuar se jetojnë në adresat me më shumë se 20 persona tjerë, ose më shumë se gjashtë mbiemra.

<sup>19</sup> Neni 196-b nga Kodi Zgjedhor i lejon KSHZ-së që të fshijë të dhënat e votuesve pa të dhëna që gjenden në bazat e të dhënave të tjera përveç regjistrimit të MPB, të cilët nuk kanë qenë prezent gjatë kontrollimit në terren, dhe të cilët nuk janë reregjistruar.

<sup>20</sup> Paragrafi 7.3 nga [OSCE Dokumenti Kopenhagës nga viti 1990](#) obligon Shtetet pjesëmarrëse të "garantojnë votim të barabartë universal të qytetarëve të rritur". Shih poashtu seksionet 1.1 dhe 1.2 nga [Kodi i praktikave të mira nga viti 2002 të Komisionit të Venedikut](#)

<sup>21</sup> Si rezultat, u bënë 176 ndryshime, u shtuan 88 persona, dhe u fshinë 71 për shkak të adresave të gabuara ose të vdekjes.

KSHZ-ja miratoi 20,573 dhe refuzoi 458 aplikacione për votim jashtë vendit.<sup>22</sup> Ishin dorëzuar aplikime të shumta nga një e-mail adresë e njejtë, me një numër të konsiderueshëm nga Internet Protokol adresat e njëjta nga Shkupi, Manastiri dhe Shtipi. Disa bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-së ngritën çështje në lidhje me integritetin e procesit. Disa parti politike informuan MVZ-në të OSBE/ODIHR-së se ato kanë ndihmuar votuesit me aplikimet. Votuesit ishin të detyruar që të deklarojnë kombësinë e tyre, që sipas KSHZ-së, ka qenë e nevojshme për të shtypur materialet zgjedhore në gjuhët e komuniteteve.

Më 18 nëntor, dy ditë pas afatit ligjor, KSHZ-ja u siguroi kandidatëve zgjedhor kopje të Listave paraprake të votuesve. LSDM kërkoi shtesën e 45 personave të cilët kishin ripërtrirë letërnjoftimet e tyre, si dhe shtesën e 348 votuesve të identifikuar nëpërmjet kontrolleve në terren të kryera nga partia si dhe fshirjen e rreth 800 votuesve që nuk janë gjetur në adresat e vbandimeve të tyre. BDI-ja kërkoi shtesën e pesë votuesve, aplikimet e të cilëve ishin vonuar nga zyrat rajonale të KSHZ-së. KSHZ-ja hodhi poshtë kërkesat e LSDM-së dhe e pranoi kërkesën e BDI-së.<sup>23</sup> KSHZ-ja poashtu miratoi 107 nga 120 fshirje të kërkuara nga një organizatë e shoqërisë civile.<sup>24</sup>

Më 28 nëntor, dy ditë pas datës zyrtare për mbylljen e Listës të votuesve, KSHZ-ja njoftoi se 1,784,416 votues janë regjistruar për të votuar në vend, nga të cilët 230.122 janë të vendosur në Listën e veçantë të votuesve që konsiderohen se përkohësisht jetojnë jashtë vendit. U krijuan edhe Listat e veçanta për 2,015 të burgosurit, 13 persona të zhvendosur brenda vendit dhe 325 anëtarë të KZ-ve jashtë vendit.

Marrëveshja politike për rishikimin e Listës të votuesve aplikohet vetëm për këto zgjedhje. Përveç kësaj, mungesat ligjore dhe strukturale për mirëmbajtjen e Listës së votuesve kryesisht për shkak të qytetarëve të regjistruar në adresat ku ata në fakt nuk jetojnë, nuk u trajtua.<sup>25</sup>

## Regjistrimi i kandidatëve

Çdo votues me të drejtë vote mund të jetë kandidat për deputet, përveç atyre të dënuar me vendim final të gjyqit për më shumë se gjashtë muaj burgim dhe që nuk e kanë përfunduar dënimin e tyre.<sup>26</sup> Ato mund të propozohen nga partitë e regjistruara politike, koalicionet e partive politike dhe grupet e votuesve. Këta të fundit duhet të sigurojnë së paku 1.000 nënskrime mbështetëse të votuesve që jetojnë në qarkun përkatës. Në linjë me rekomandimet e mëparshme të ODIHR/OSBE-së dhe të Komisionit të Venedikut, për herë të parë, një votues mund të nënshkruajë mbështetje të më shumë se një listë të kandidatëve; Megjithatë, ende është e nevojshme që nënshkrimet të mblidhen para një punonjësi të KSHZ-së.

Regjistrimi i kandidatëve u zhvillua nga 18 tetori deri më 11 nëntor dhe ishte në përgjithësi përfshirës. Megjithatë, ishte negativisht i ndikuar nga mungesa e qartësisë ligjore në disa aspekte të emërimit dhe regjistrimit, duke përfshirë verifikimin e nënshkrimeve dhe ri-dorëzimin e dokumenteve për

<sup>22</sup> Sipas KSHZ-së, që nga 21 tetori, zyrtarisht ka pasur 76,721 qytetarë me banim të përkohshëm jashtë vendit.

<sup>23</sup> KSHZ-ja e justifikoi vendimin e saj me arsye se votuesit do të mund të shtohen në Listën e votuesve vetëm në bazë të aplikimit personal. Kjo është në kundërshtim me nenin 49-a të Kodit Zgjedhor, që ju lejon partive të kërkojnë "futjen e të dhënave" në Listën e votuesve. Gjithashtu, KSHZ-ja poshtu konsideroi se LSDM-ja nuk mund të përdor kontrollet e saja në terren si baza për fshirjen e votuesve, dhe se është dashur të bazojë kërkesën e saj vetëm mbi informacionet ekzistuese në regjistrin paraprak.

<sup>24</sup> Zyra lokale e Transparency International kërkoi nga KSHZ-ja fshirjen e 120 votuesve me vendbanim në ndërtesën e Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB). MPB-ja anuloi 107 shënime për shkak të regjistrimit të paligjshëm.

<sup>25</sup> Dispozitat ligjore që rregullojnë regjistrin e adresave, duke përfshirë edhe përditësimin e shënimeve, fshirjes së adresave të skaduara dhe parandalimin e regjistrimit në adresat me prova të pamjaftueshme është në kundërshtim. Përveç kësaj, rregulli që kërkon personat të deklarojnë ndryshime të adresës nuk po zbatohet.

<sup>26</sup> Ligji gjithashtu identifikon një sërë të pozitive qeveritare dhe posteve qeveritare të lidhura si të papërshtatshme me kandidaturën.

regjistrim,<sup>27</sup> dhe me jokonzistencën e verifikimit të dokumentacionit nga ana e KSHZ-së. Kjo drejtoi në refuzimin e një numër të listave nga Partia Social Demokratike e Maqedonisë (SDPM) dhe të Lëvizjes Popullore për Maqedoninë (LPM).<sup>28</sup> Të dzja partitë ankimuan vendimet e KSHZ-së në Gjykatën Administrative, e cila la në fuqi vendimet e KSHZ-së.

KSHZ-ja regjistroi 6 parti politike dhe 5 koalicione që listuan një total prej 1,092 kandidatë në 58 lista.<sup>29</sup> Në përputhje me kuotën e zgjeruar për rritje të pjesëmarrjes së grave, 41 për qind nga kandidatët ishin gra, edhe pse vetëm 4 nga 58 listave kishin gra në krye të listave.<sup>30</sup> KSHZ-ja regjistroi listen e kandidatëve për VMRO-PP jashtë vendit dhe dy listat vendore të *Levica* pavarësisht nga mosplotësimi i kërkesës gjinore.

## Ambienti i fushatës

Partitë në përgjithësi kishin mundësinë që të dalin në fushata të lira, ku liritë themelore për asociim, tubim dhe shprehje ishin të respektuara. Fushata u zhvillua në një ambient të karakterizuar me mungesë të besimit publik në institucionet dhe në sistemin politik.

Kandidatët fushatat e tyre i zhvilluan me viztita derë më derë, me takime të përmasave të vogla dhe tubimeve. Bilbordet e katër partive kryesore ishin të dukshëm në shumë komuna. Megjithatë, vendosja e posterave të fushatës dhe banderolat në vende publike dallonte mes komunave për shkak të lokacioneve që nuk ishin të shënuara në mënyrë të qartë dhe mungesës së vetëdijes te disa autoritete lokale për detyrimin e tyre ligjor për të caktuar vende të tilla. Në tubimet anembanë vendit në përgjithësi kishte pjesëmarrje të mirë, por disa audiencë kishin mungesë të entuziazmit. Femrat përbënin një mesatare prej 20 për qind të audiencës dhe shumë pak prej tyre mbajtën fjalime. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përfitoi nga mbështetja e publikut, duke përfshirë në tubimet e tyre zyrtarë të lartë nga vendet anëtare të BE-së. Mediat sociale përdorshin gjerësisht gjatë fushatës, duke përfshirë këtu edhe partitë më të vogla.

Mesazhet kryesore në fushatat u përqendruan në ekonominë, emigrimin e të rinjve dhe krijimit të vendeve të punës. Ndërsa shumica e kandidatëve përdorën fushatë pozitive, u vërejt edhe retorika negative. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përdori mesazhe nacionaliste dhe akuzoi koalicionin e udhëhequr nga LSDM-ja për përpjekje për të dobësuar identitetin kombëtar, duke i paraqitur zgjedhjet si një referendum për një shtet unitar dhe sovran. Nga ana tjetër, koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja akuzoi koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE për abuzim të pushtetit shtetëror dhe për veprimtari kriminale. Fushatat e partive etnike shqipëtare u drejtuan vetëm komineteteve të tyre.

Akuzat e vazhdueshme për frikësimin e votuesve, kërcënimet, shtypje mbi të punësuarit publik, blerjen e votave në komunitetin rom dhe keqpërdorim të burimeve administrative ndikuan negativisht fushatën.

<sup>27</sup> KSHZ-ja ka publikuar dokumentacionin e kërkuar për regjistrim të kandidatëve më 1 nëntor.

<sup>28</sup> KSHZ I informoi partitë që të korrigjojnë një numër të parregullësive, duke përfshirë dhe certifikatat të mosgjykimit dhe deklaratat e nënshkruara që konfirmojnë etnicitetin, qarkun zgjedhor, dhe pranimin e kandidaturës. Megjithatë, KSHZ-ja përfundimisht hodhi poshtë të gjitha listat e tyre, disa për shkak të parregullësive të cilat fillimisht nuk ishin të komunikuar. Verifikimi i nënshkrimeve nuk është i rregulluar me Kodin Zgjedhor. KSHZ-ja e përdori fuqinë diskrete në mënyrë jokonzistente për të verifikuar nënshkrimet dhe i hedhi poshtë listat pa njoftim paraprak për të lejuar korrigjime të caktuara.

<sup>29</sup> Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE "Për një Maqedoni më të mirë" përfshiu 25 parti dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM "Për Jetë" përfshiu 14. Koalicionet tjera janë Aleanca për Shqiptarët (PDSH - Lëvizja për Reforma, Uniteti dhe RDK), koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi (Bashkimi Demokratik, FRODEM, Moro - Partia e Punëtorëve dhe DEMOS) dhe VMRO-Koalicioni për Maqedoninë (VMRO-PP, Të Bashkuar për Maqedoninë dhe Krenaria). Gjashtë partitë e regjistruara janë BDI, PDSH, BESA, Levica, Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Liberale. Një e treta e 123 deputetëve të tanishëm nuk ka konkurruar në këto zgjedhje.

<sup>30</sup> Kuota është rritur me 10 për qind në krahasim me zgjedhjet e 2014. Çdo kandidat i tretë dhe i dhjeti në një listë duhet të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar.



MVZ e OSBE/ODIHR-së verifikoi një duzinë të këtyre fajësimeve.<sup>31</sup> Veprimet e tilla ngritën brenga në lidhje me mundësinë e votuesve për të hedhur votën e tyre "të lirë nga frika e hakmarrjes", siç parasheh paragrafi 7.7 nga Dokumenti i OSBE-së nga Kopenhaga të vitit 1990.<sup>32</sup>

Gjatë fushatës u vërenë një numër i incidenteve të dhunshme, duke synuar një gamë të partive politike.<sup>33</sup> Fushata brenda komunitetit shqiptar ishte më intensive, me një retorikë nxitëse nga PDSH-ja, BESA, Aleanca për shqiptarët dhe BDI-ja. Në rrjetet sociale gjatë fushatës u postuan biseda të reja nga përgjimet e zyrtarëve të BDI-së. Disa parti raportuan për vështirësi për hapje të shtabeve zgjedhore në rajone të caktuara të kontrolluara nga BDI.<sup>34</sup>

## Financimi i fushatës

Nga kandidatët zgjedhor u kërkua që të hapin një llogari bankare të dedikuar për qëllime të financimit të fushatës. Individët mund të bëjnë donacione deri më 3,000 euro, kurse personat juridik deri më 30,000 euro. Donacionet nga jashtë vendi ose ato anonime dhe nga organizata në pronësi shtetërore, fetare dhe humanitare janë të ndaluara. Kandidatët mund të shpenzojnë maksimum 1.8 euro për votues të regjistruar në njësi. Çdo listë do të rimbursohet me 0,25 euro për çdo votë të fituar me kusht që të fitohen së paku 1.5 për qind nga votat e hedhura në njësi.

Të gjithë 11 kandidatët në zgjedhje dorëzuan raporte të përkohshme financiare të fushatës më 1 dhe 10 dhjetor duke i deklaruar donacionet e pranuar si dhe shpenzimet e tyre, të cilat ishin të publikuara në internet. Shpenzimet në nëntë raporte treguan mbikalim të kontributave, ku VMRO-DPMNE ka mospërputhje më të lartë në lartësi prej më shumë se 600.000 euro në raportin e parë dhe 1 milion euro në raportin e dytë.<sup>35</sup> Raportet e paraqitura nga BESA dhe VMRO-PP përmbanin donacione që kanë tejkalar kufirin e lejuar.<sup>36</sup> Të gjithë kandidatët janë të detyruar të dorëzojnë raportet përfundimtare brenda 30 ditëve nga mbyllja e llogarisë, që mund të zgjasë deri më katër muaj pas zgjedhjeve.<sup>37</sup>

Rregulloret e financave të fushatës janë gjithëpërfshirëse dhe kërkojnë raportime të shpeshta nga ana e kandidatëve. Megjithatë, transparenca u zvogëluar nga mungesa e kërkesës për të mbështetur raportet me pasqyrat dhe faturat bankare. Buroja Shtetërore e Auditimit informoi MVZ-në të OSBE/ODIHR-së se mund të kryejë auditim, duke përfshirë një kontrollim të kryqëzuar të shpenzimeve në nivel lokal, por vetëm në rast të ankesave.

<sup>31</sup> Duke përfshirë edhe raportet për blerjen e votave dhe presion mbi individët, familjet e tyre, përfaqësuesit e pakicave etnike, të punësuarve publik dhe privat dhe mediat, kryesisht nga ana e VMRO-DPMNE-së dhe BDI-ja.

<sup>32</sup> Paragrafi 7.7 i Dokumentit të OSBE-së nga Kopenhaga e vitit 1990, obligon shtetet pjesëmarrëse "të sigurojnë që ligji dhe politikat publike të lejojnë që fushatat politike të zhvillohen në një atmosferë të drejtë dhe të lirë në të cilën as veprimi administrativ, dhuna e as frikësimi do të kufizon partitë dhe kandidatët nga prezantimi i lirë i pikëpamjeve dhe kualifikimeve të tyre, apo të pengon votuesit nga të mësuarit dhe diskutimit të tyre, ose të hedhin votën e tyre pa frikën e ndëshkimit". Shih poashtu [Udhëzimet e përbashkëta për parandalimin dhe përgjigjen ndaj abuzimit të burimeve administrative gjatë proceseve zgjedhore të OSBE/ODIHR-së \(dhe Komisionit të Venedikut\)](#).

<sup>33</sup> Një numër i zyrave lokale të partive u dëmtuan apo vandalizuan (LDSM Haraçinë më 7 nëntor, VMRO-DPMNE në Kavadar më 18 dhe 26 nëntor, PRSD në Aerodrom më 22 nëntor, dy zyrat e VMRO-DPMNE-së në Negotinë më 23 nëntor, BDI Sllupçan më 25 nëntor). Më 9 nëntor, makina e presidentit të degës të GROM në Strumicë ishte ndezur; më 13 nëntor, makina e liderit të BDI-së u gjuajt me gurë nga një grup i banorëve lokal në Kumanovë. Disa bilborde janë shkatërruar: i BDI-së në Kumanovë dhe Gjorçe Petrov; i BESA-së në Saraj; i VMRO-DPMNE-së në Strumicë, Shtip, Kumanovë dhe Berovë.

<sup>34</sup> BESA, PDSH dhe LDSM deklaruan pengesa në gjetjen e zyreve partiake në rajonin e Tetovës.

<sup>35</sup> Raporte tjera përfshinë BESA, Partinë Liberale, PPD, BDI, PDSH, *Levica*

<sup>36</sup> Kodi Zgjedhor parashikon një gjorbë deri në 9.000 euro në kundërvlerë me denarë për dështimin e paraqitjes të raporteve financiare të fushatës, dhe pezullimin ose humbjen (pjesërisht ose tërësisht) të rimbursimit të shpenzimeve të zgjedhjeve për të kaluar kufirin e shpenzimeve. Kodi Penal shqipton dënim me burg prej së paku pesë vjetësh për dështim të paraqitjes të një raporti dhe/ose tejkalimit të kufinjve të shpenzimeve.

<sup>37</sup> Paragrafi 200 i vitit 2010 i [2010 OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venedikut – Udhëzuesi për rregulloret për part politike](#) thotë se "Raportet për financimin e fushatës duhet dorëzuar në autoritetet përkatëse brenda afatit kohor e jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve"

## Mediat

Media të shumta, duke përfshirë mbi 130 transmetues, veprojnë në një treg relativisht të vogël me media të ndara sipas vijave politike dhe etnike. Reformat e rëndësishme mediale të parapara me marrëveshjen e Përzihino-së ende mbeten si çështje për tu dakorduar.

Kodi Zgjedhor rregullon mbulimin mediatik të zgjedhjeve. Të gjithë transmetuesit duhet të sigurojnë mbulim të balancuar gjatë periudhës së fushatës. Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM) duhet të sigurojë qasje në emitim falas, të organizojë debate dhe të sigurojë mbulim të balancuar të kandidatëve në lajme.<sup>38</sup> Ndryshimet nga viti 2015 ndalojnë reklamimet e financuara nga qeveria dhe mbulimin e zyrtarëve shtetëror në favor të partive politike gjatë zgjedhjeve. Ndryshimet shtesë nga viti 2016, të zbatueshme vetëm për këto zgjedhje, mundësuan caktimin e kryeredaktorit të MRT1 të emëruar nga opozita 100 ditë para zgjedhjeve (mandati i të cilit do të përfundojë në natën e zgjedhjeve), dhe formimin e Komisionit të përkohshëm për mbikëqyrje të mbulimit mediatik gjatë periudhës parazgjedhore.<sup>39</sup>

Komisionit të përkohshëm i'u dha mandat për të mbikëqyruar mediat për më shumë se tre muaj para zgjedhjeve. Megjithatë, disa dispozita nuk ishin plotësisht të harmonizuara me pjesët e tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat në mënyrë rigoroze rregullojnë mbulimin e kandidatëve vetëm gjatë fushatës zyrtare 20-ditore, duke krijuar një pasiguri rreth mandatit të tij. Komisioni ka propozuar 57 procedura kundërvajtëse, kryesisht në lidhje me mbulim të paekuilibruar, fushatë të fshehur nga ana e zyrtarëve qeveritarë, si dhe reklamim të paguar politik. Para ditës së zgjedhjeve, gjykata solli vendim për dy raste të cilët i refuzoi. Edhe pse kjo kërkohet me ligj, AAVMS nuk e ka mbikëqyruar mbulimin e zgjedhjeve në mediat elektronike, për shkak të rregullativave të paqarta.

Të gjithë kandidatët zgjedhor kishin mundësi qasjeje në media për fushatë, duke përfshirë edhe emitim falas në mediat elektronike publike si dhe reklamim të paguar. Disa parti joparlamentare u ankuan për mundësi të pamjaftueshme për të prezantuar mesazhet e tyre në media, duke përfshirë edhe kufizimet për reklamim në mediat transmetuese private.<sup>40</sup> Përpjekjet për të organizuar debate me të gjithë kandidatët kryesor ishin kryesisht të pasuksesshme për shkak të refuzimit të kandidatëve për të marrë pjesë.<sup>41</sup>

Shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR-së, duke përfshirë edhe gazetarë, vërejtën vetëcensurim dhe mungesë të pavarësisë editoriale për shkak të intereseve politike dhe të biznesit të pronarëve. Gjatë fushatës, MVZ e OSBE/ODIHR u informua për një rast të fajësisimit për kërcënim të një redaktori të lajmeve nga ana e një përfaqësuesi nga BDI. Bashkëbiseduesit poashtu ngritën brenga për përdorimin e fushatës mediatike të financuar nga qeveria (në pritje për shkak të periudhës zgjedhore) si mënyrë për mbështetje dhe shpërplim të degëve miqësore.

<sup>38</sup> Transmetuesi publik, MRT, operon me MRT1, MRT2 dhe me Kanalin Parlamentar. Neni 76a (2) i Kodit Zgjedhor parashikon se mbulimi i çdo program të lajmeve duhet të ndahet, me 30 për qind të çdo lajmi për ngjarjet vendore dhe ndërkombëtare, 30 për qind për aktivitetet e fushatës për shumicën parlamentare, 30 përqind për opozitën parlamentare dhe 10 për qind për partitë joparlamentare.

<sup>39</sup> Trupi pesë anëtarësh është i përbërë nga katër të nominuarve politik (dy nga partitë qeverisëse dhe dy nga opozita), dhe një anëtar i pestë i zgjedhur nga katër të parët. Komisioni zëvendësoi rolin mbikëqyrës të Agjencisë Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale (AAVMS), organi rregullator për mediat elektronike. Komisioni vlerësoi mbulimin mediatik në bazë të raporteve të monitorimit të përgatitura nga AAVMS.

<sup>40</sup> Palët që nuk janë të përfaqësuar në parlament janë të lejuara për të blerë vetëm një minutë të reklamave në orë, në krahasim me 17-minuta kohë të tillë emitim për partitë parlamentare.

<sup>41</sup> Në *Alsats - M* më 29 nëntor u zhvillua një debat i rëndësishëm nga i cili përfituan nga pjesëmarrja e udhëheqësve të listës në qarkun 1 nga VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH.

Rezultatet e monitorimit të mediave nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-së treguan se të dy kanalet televizive publike punuan në përputhje me rregulloren për ndarje të drejtë të mbulimit të grupeve gjatë periudhës së fushatës.<sup>42</sup> Në programet e lajmeve të MRT1, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe BDI kishin nga 20 për qind mbulim secili, ndërkohë që partive të opozitës i'u ndanë 42 për qind dhe partitë joparlamentare kishin 11 për qind. Në MRT2, ndarja e kohës së mbulimit midis partive qeveritare dhe ato të opozitës ishte ngjashëm e drejtë, me më shumë kohë të ndarë për partitë etnike shqipëtare. MRT1 dhe MRT2 pasqyruan kandidatët përgjithësisht në mënyrë pozitive dhe jokritike.

Mediat private *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa* dështuan të sigurojnë mbulim të balancuar dhe të paanshëm. Edhe pse ata kryesisht i'u ndanë pjesë të barabarta të kohës së transmetimit VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, pasqyrimi ishte shumë pozitiv për të parit dhe shpeshherë negativ për të dytit, në veçanti në *Sitel*. Të tre kanalet haptazi mbështetën partinë në pushtet dhe dukshëm u fokusuan në temat e fushatës të VMRO-DPMNE-së. Herë pas here paraqiteshin informacione të dyshimta me origjinë nga interneti si lajm politik në këto kanale.

Kanalet tjera private, *Alsat-M*, *Telma* dhe *24 Vesti*, ofruan mbulim të ndryshëm dhe shpesh kritik të kandidatëve kryesor dhe të aktorëve politik në lajmet e tyre dhe poashtu u siguruan kandidatëve mundësi për të paraqitur platformat e tyre në debate apo në intervistat. Gazetat e monitoruara në përgjithësi ofruan shumëllojshmëri të pikëpamjeve, duke anuar nga parti të caktuara.

### **Pjesëmarrja e pakicave etnike<sup>43</sup>**

Partitë dhe koalicionet që kryesisht përfaqësojnë komunitetin etnik shqiptar u kandiduan si të pavarura, ndërsa partitë dhe kandidatët që përfaqësojnë komunitetet më të vogla u bashkuan koalicioneve të udhëhequra nga partitë që përfaqësojnë komunitetet më të mëdha.<sup>44</sup> Të dy koalicionet të udhëhequra nga LSDM-ja dhe nga VMRO-DPMNE-ja, në listat e tyre i përfshinë përfaqësues të pothuajse të gjithë komuniteteve më të vogla, disa edhe në pozicione më mundësi për të fituar. Ashtu edhe si në të kaluarën, shumica e partive që përfaqësojnë komunitetet më të vogla garuan në kuadër të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja në mënyrë aktive i kërkoi votat e komunitetit etnik shqiptar, duke përfaqësuar kandidatë etnik shqiptar në pozita fitimtare, që fatkeqësisht nuk u pranua mirë nga partitë etnike shqipëtare të etabluara.

Temat që kishin të bëjnë me marrëdhëniet ndëretnike karakterizuan dukshëm fushatën, duke përfshirë edhe marrëdhëniet institucionale mes bashkësive etnike shqiptare dhe maqedonase dhe përdorimin zyrtar të gjuhëve. Gara zgjedhore ishte veçanërisht intensive në komunitetin etnik shqiptar. Aleanca për shqiptarët dhe BESA e sfiduan pozitën dominuese të BDI-së. Mbulimi mediatik i bashkësive më të vogla dhe pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet, duke përfshirë tubime dhe deklarata nga palët, ishte i kufizuar. Raportimi mbi aktivitetet politike nga komunitetet më të vogla, veçanërisht ai rom, shpeshherë u bë përmes stereotipeve negative. Përderisa materialet zgjedhore u siguruan në gjuhët e pakicave etnike, nuk kishte fushatë specifike për edukim të votuesve në gjuhën e komuniteteve më të vogla.<sup>45</sup>

<sup>42</sup> Monitorimi i mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR-së u realizua nga 7 nëntori deri më 10 dhjetor dhe përfshiu programet qendrore të transmetimit nga kanalet televizive publike *MRT1* dhe *MRT2* dhe televizionet private *Sitel*, *Kanal 5*, *Alfa*, *Telma* dhe *Alsat-M* (mes orëve 18:00 dhe 24:00), si dhe programet të lajmeve kryesore të *24 Vesti* (transmetuar në orën 20:00), po edhe gazetat ditore *Dnevnik*, *Koha*, *Lajm*, *Sloboden Peçat* dhe *Vest*.

<sup>43</sup> Korniza ligjore kombëtare referohet për kombësitë etnike. Neni 48 i Kushtetutësthotë se "Republika garanton mbrojtjen e identiteteve etnike, kulturore, gjuhësore dhe profesionale të kombësive"

<sup>44</sup> Shumica e partive që përfaqësojnë komunitetet jo-etnike shqiptare në mënyrë të vazhdueshme bënin thirrje për krijimin e një njësi të veçantë zgjedhore dhe për krijimin e vendeve të rezervuara ose të garantuara në kuvend, për t'ju mundësuar që të hyjnë në fushatë të pavarur.

<sup>45</sup> Regjistrimi i fudit është bërë në vitin 2002. Ishte i planifikuar një regjistrim i ri në vitin 2011, por u anulua, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve mbi se si duhet regjistruar personat që nuk banojnë në vend, si dhe përpjekjet e dy komuniteteve kryesore për të maksimizuar numrin e tyre gjatë numërimit .

## Ankesa dhe Ankimime

KSHZ-ja u morr me shumicën e kontesteve administrative në lidhje me zgjedhjet, kurse BSHA dhe KSHPK i trajtuan ankesat në lidhje me financat e fushatave dhe keqpërdorimin e burimeve administrative. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor nga viti 2015 forcuan garancat ligjore për zgjedhjen e kontesteve zgjedhore. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venedikut, kjo përfshinte afate më të shkurtra, publikimin e vendimeve administrative brenda 24 orëve, si dhe garantimin e të drejtës për ankimim për të gjitha vendimet administrative në Gjykatën Administrative. Përveç kësaj, në linjë me rekomandimet e mëparshme, KSHZ-ja miratoi Rregullore për procedurat e trajtimit të ankesave.

KSHZ-ja pranoi 11 ankesa para ditës së zgjedhjeve, shumica e të cilëve u hodhën poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit ose të dëshmimeve.<sup>46</sup> Pavarësisht detyrimit ligjor, KSHZ-ja nuk e implementoi sistemin elektronik për menaxhim të rasteve dhe të ankesave. Dy vendime lidhur me refuzimin e listave të PSDM-së dhe LKM-së janë ankimuar në Gjykatën Administrative dhe të dyja u hodhën poshtë, në seancë të mbyllur, si të pabaza.<sup>47</sup> Edhe pse të dy vendimet u publikuan në faqen e saj, mungesa e dëgjimeve publike është në kundërshtim me përcaktimet e OSBE-së dhe detyrimeve tjera ndërkombëtare.<sup>48</sup> Përveç kësaj, një numër i bashkëbiseduesve ngritën brenga për pavarësinë e gjyqësorit. Në përgjithësi, edhe pas përmirësimeve në ligj, zbatimi i procedurave për zgjedhjen e kontesteve zgjedhore nuk mundësoi një sistem efektiv të dëshmipërblimit, që është në kundërshtim me përcaktimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.<sup>49</sup>

KSHPK pranoi rreth 1,000 kërkesa për sqarime mbi çështje që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e burimeve administrative, shumica prej të cilëve kanë ishin anonime ose me pak prova. Më 1 dhjetor, KSHPK-ja kërkoi nga Prokuroria Themelore Publike fillimin e hetimeve në dy prej rasteve.<sup>50</sup> Përveç kësaj, Avokati i Popullit inicioi 10 hetime lidhur me akuzat për presion mbi punonjësit publik dhe korrigjimet në Listat e votuesve, që janë në zhvillim e sipër.

U paraqitën edhe dy iniciativa të tjera në Gjykatën Kushtetuese duke sfiduar kushtetueshmërinë e dispozitave të lidhura me zgjedhjet. Më 9 nëntor, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë të dyjat: njëren nga BESA, duke sfiduar dispozitën në anë të cilës kërkohet që votuesit me të dhëna "të dyshimta" të bëjnë reregjistrim (si pa juridiksion) dhe një nga LKM, duke sfiduar përbërjen e Komisionit të Përkohshëm (si të pabazë).

<sup>46</sup> Ankesat ishin kryesisht në lidhje me ankesat për fushatë të hershme, shkelje të Nenit 8-a të Kodit Zgjedhor i cili ndalon punësime të reja ose ndërprerje të punës në institucionet shtetërore dhe publike; pjesërisht nga kryetarët dhe anëtarëve të dy KKZ-ve; dhe ndryshimin e vendndodhjes të qendres së votimit.

<sup>47</sup> Sipas Kushtetutës, seancat gjyqësore dhe miratimi i vendimeve janë publike. Publiku mund të përjashtohet vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. Ligji për Gjykatat thotë se procedimet para gjykatave duhet të bazohen në parimin e publicitetit dhe transparencës.

<sup>48</sup> Paragrafi 12 i [OSBE Dokumentit të Kopenhagës nga viti 1990](#) thekson se "procedimet mund të mbahen para kamerave vetëm në rrethana të përcaktuara me ligj dhe në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligjet ndërkombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare". Shih gjithashtu Nenin 10 të [Deklaratës universale e të drejtave të njeriut](#) dhe Nenin 14 nga [ICCPR](#).

<sup>49</sup> Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 thotë se "të gjithë do të kenë një mjet efektiv për t'u ankuar kundër vendimeve administrative, në mënyrë që të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe të sigurohet integriteti ligjor". Poashtu shih paragrafin 3.3 nga 2002 [Kodi i Praktikave i Komisionit të Venedikut](#)

<sup>50</sup> Një e dorëzuar nga Zëvendësministri Plotësues i Punëve të Brendshme, i cili akuzoi për keqpërdorim të pozitës zyrtare nga ministri i cili i ka zhvendosur të punësuarit dhe i ka rritur pagat e tyre. E dyta, e paraqitur nga VMRO-DPMNE, duke akuzuar për përdorim të automjeteve zyrtare për transportin e materialeve të fushatës të LSDM-së nga ana e Ndërmarrjes Komunale Publike - Kumanovë, nga Kryetari i Komunës së Kumanovës dhe LSDM-ja.

## Vëzhgimi i Zgjedhjeve

Kodi Zgjedhor lejon vëzhgim qytetar, partiak dhe ndërkombëtar. Dy grupe vëzhguese qytetare i vëzhguan zgjedhjet: MOST shpërndau 80 VAGJ dhe disa 3300 VASH, dhe CIVIL shpërndau 35 VAGJ dhe disa 300 VASH. MOST gjithashtu zhvilloi tabelim paralel të votave. Pjesëmarrja e vëzhguesve qytetarë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor kontribuoi në transparencën e zgjedhjeve. Dhjetë organizatat e shoqërisë civile, duke punuar në fushatën e ndërgjegjësimit të votuesve, ishin të njoftuara për auditime të ardhshme financiare, ditë para dhe menjëherë pas ditës së zgjedhjeve. Këto organizata ngritën qështje në lidhje me kohën e auditimit të tillë.

## Votimi i Hershëm dhe Dita e Zgjedhjeve

Votimi i hershëm dhe dita e zgjedhjeve në përgjithësi vazhduan në mënyrë të rregullt dhe pa incidente të mëdha apo tensione. Nga prania e qytetarëve të shumtë dhe vëzhguesve partiak gjatë tërë ditës (76 dhe 97 përqind, përkatësisht) në vendvotimet e vëzhguara përfitoi transparenca.

Votimi i hershëm u mbajt më 7 dhjetor për anëtarët e KZ-ve jashtë vendit dhe më 10 dhjetor për votuesit brenda kufijve të vendit, personave të zhvendosur brenda vendit, të paraburgosurve dhe të dënuarve. Votimi i hershëm u vlerësua pozitivisht në të gjitha por 3 vëzhgimeve. Problemet procedurale të vërejtura ishin në lidhje me kutitë e votimit të pambyllura si duhet në 7 raste dhe fshehtësi e votës jo-gjithëmonë e siguruar në 8 raste. Gjatë votimit në burgun më të madh të vendit, Idrizovë, vëzhguesit kanë vërejtur disa të burgosur me letërnjoftime të vlefshme duke mos qenë në gjendje për të votuar për shkak se nuk ishin në Listën e votuesve. Mbi 500 të burgosur nuk ishin të përfshirë në listë për shkak të letërnjoftimeve të skaduara. Nuk ka procedurë për ripërtëritje të letërnjoftimeve të skaduara të të burgosurve.

Në ditën e zgjedhjeve, pothuajse të gjitha qendrat e votimit të vëzhguara u hapën në kohë. Procesi i hapjes u vlerësua pozitivisht në shumicën e rasteve, megjithatë, vëzhguesit vunë re probleme procedurale: në 20 raste protokollin i kërkuar nuk ishte plotësuar para votimit, në 21 raste kutitë e votimit nuk ishin treguara të jenë bosh dhe në 10 raste numrat e vulave të sigurisë të kutive të votimit nuk ishin të regjistruara.

Procesi i votimit u vlerësua pozitivisht në 97 për qind të vëzhgimeve. Procedurat në përgjithësi ishin të ndjekura, duke përfshirë edhe ato për mbrojtje kundër votimit të shumëfishtë, si njirosjen e gishtave të votuesve dhe kontrollimi i fotografive në Listën e votuesve. Regullimi i ambientit në 4 për qind të vendvotimeve të vëzhguara u vlerësua si e pamjaftueshëm. Në gjysmën e këtyre rasteve, kjo ka ndikuar fshehtësinë e votës. Mbipopullimi ishte vërejtur në 5 për qind të vendvotimeve të vizituara. Më shumë se gjysma e vendvotimeve të vëzhguara nuk kanë lejuar qasje të pavarur për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

Në mënyrë domethënëse, në 16 për qind të vendvotimeve të vëzhguara të votimit, kishte persona që nuk ishin të lejuar të votojnë pasi që nuk ishin në listat e votuesve. Ndërsa disa prej këtyre qytetarëve ishin të ridrejtuar në stacionet e tjera të votimit, të tjerë deklaruan se ata kishin qenë pjesë e 28,341 të dhënave të fshira në korrik të vitit 2016. Një total prej 335 të personave të prekur parashtruan ankesa në KSHZ për këtë çështje. Kjo e thekson nevojën e vazhdueshme për të trajtuar në mënyrë të qëndrueshme të metat strukturore në regjistrin e votuesve.

U vërenë disa parregullsi serioze gjatë votimit, të tilla si votim në grup (4 për qind), votim për tjetër (2 për qind), kutitë e votimit të pambyllura sipas rregullave (2 për qind). Incidentet e votuesve nën presion dhe të personave të paautorizuar duke e udhëzuar punën e KZ-ve poashtu janë vërejtur. Gjatë ditës, një

numër i raporteve policore dhe të mediave informuan për parregullsi që kanë të bëjnë me blerje të votave dhe fotografim të fletëve të votimit. Të paktën gjashtë persona u arrestuan.

Procesi i numërimit u vlerësua si efikas dhe transparent nga vëzhguesit e MNVZ-së. Megjithatë, u vërejtën lëshime të mëdha procedurale në një numër të vendvotimeve dhe numërimi u vlerësua negativisht në 10 KZ të vëzhguara. Kjo e kryesisht ishte e lidhur me hapat e ndërmarrë para hapjes së kutive të votimit, duke përfshirë edhe numërimin e nënshkrimeve dhe fletëve të votimit të papërdorura (28 dhe 25 raste, përkatësisht), si dhe verifikimin e numrave të vulave të sigurisë të kutive të votimit (14 raste). Pas numërimit, 16 KZ të vëzhguara u vëre se kishin vështirësi gjatë plotësimit protokolleve të rezultateve, dhe se 14 KZ nuk i ndjekën procedurat për paketimin e materialeve të ndjeshme zgjedhore dhe fletëve të votimit. Kopjet e protokollit ju dorëzuan atyre që i kanë kërkuar ato; megjithatë, 33 KZ-të e vëzhguara nuk i postuan protokollin, siç kërkohet nga ligji. Numërimi përfundoi në afatin në mesnatë në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Tabulimi vazhdoi në kohën e duhur, por u vlerësua negativisht në 8 vëzhgime. Problemet kryesore të vërejtura ishin në lidhje me kushtet në KKZ-të: hapësira e pamjaftueshme (24 KKZ), mbipopullim (22 KKZ) dhe organizimi i dobët (9 KKZ). Gjatë vëzhgimit, 336 protokolle të numërimit kishin mospërputhje dhe u rinumëruan fletët e votimit nga 40 qendra të votimit.

Edhe pse nuk kërkohet me ligj, rezultatet paraprake nga vendvotimet dhe njësive ishin të publikuara në internet nga KSHZ-ja gjatë tërë natës, që kontribuoi në transparencën e procesit. KSHZ-ja njoftoi pjesëmarrjen paraprake të votuesve me 67 për qind.

---

## INFORMACION DHE MIRËNJOHJE RRETH MISIONIT

---

Shkup, 12 dhjetor 2016 - Kjo Deklaratë e Konstatimeve dhe Konkluzioneve Paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (OSBE/ODIHR), Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (OSCE AP), Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) dhe Parlamentit Evropian (PE). Vlerësimi është bërë për të përcaktuar nëse zgjedhjet janë në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet tjera ndërkombëtare si dhe standardet për zgjedhje demokratike dhe me legjisllacionin kombëtar.

Roberto Battelli u emërua nga Kryesuesi i OSBE-së si Koordinator Special dhe Udhëheqësi i misionit vëzhgues afatshkurtë i OSBE-së. Azay Guliyev kryesoi delegacionin e OSBE AP-së. Stefan Schennach kryesoi delegacionin e APKE-së. Igor Šoltës kryesoi delegacionin e PE-së. Tana de Zulueta është Shefe e OSBE/ODIHR-së, i vendosur nga 3 nëntori.

Secili nga institucionet e përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) ka miratuar Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve nga viti 2005. Kjo Deklaratë e Konstatimeve dhe Konkluzioneve Paraprake është dorëzuar para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga realizimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave dhe ankimeve të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do të nxjerrë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandimet për përmirësime të mundshme, rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. AP e OSBE-së do të prezantojë raportin e saj në Takimin Dimëror 2017. APKE do të prezanton raportin e saj në janar në takimin e parë të seancës të pjesërishtme në Strazbur. PE do të prezanton raportin e tij në takimin në vijim me Komitetin e Punëve të Jashtme.

MNVZ i OSBE/ODIHR-së përfshin 16 ekspertë në kryeqytet dhe 20 vëzhgues afatgjatë të vendosur në tërë vendin. Në ditën e zgjedhjeve u vendosën 335 vëzhgues nga 42 vende, duke përfshirë edhe 227 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të angazhuar nga OSBE/ODIHR, si dhe një delegacion 24 anëtarësh nga AP të OSBE-së, një delegacion 19 anëtarësh nga APKE, si dhe një delegacion 15 anëtarësh nga PE. Hapja u vëzhguar në 92 vendvotime dhe votimi u vëzhguar në 1,337 vendvotime në tërë vendin. Numërimi u vëzhguar në 131 vendvotime, dhe tabulimi në të gjitha 80 KKZ-të.

Vëzhguesit dëshirojnë të falenderojnë autoritetet për ftesën e tyre për të vëzhguar zgjedhjet, si dhe KSHZ-në dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën e tyre. Ata gjithashtu shprehin mirënjohjen e tyre ndaj institucioneve të tjera shtetërore, partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni:

- Tana de Zulueta, Shefe e MVZ të OSBE/ODIHR në Shkup (+ 389 2 3222 558);
- Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR-së (+48 609 522266), ose Tamara Otiashvili, Këshilltare për Zgjedhje në OSCE/ODIHR, Varshavë (+48 696 808829);
- Iryna Sabashuk, OSBE AP Shefe e Administratës për Vëzhgim të Zgjedhjeve (+45 6010 81 73);
- Bogdan Torcatoriu, Sekretari i delegacionit të AKPE-së (+336 5039 30 40);
- Gerrard Quille, Shefi i shërbimit, Mbështetje për ndërmjetësim nga PE, Parlamenti Evropian (+32 228 32260).

**MZV i OSBE/ODIHR-së Adresa:**

6 Nikolla Kljusev, 1000 Shkup

Tel: + 389 2 3222 558, Fax: + 389 2 3226 776, Email: [office@odihr.mk](mailto:office@odihr.mk)

Website: <http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/279061>

*Verzioni në gjuhën angleze i këtij Raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.  
Në dispozicion janë edhe përkthimet jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe shqipe.*